

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.997-5/2016 të datës 21.09.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Sahide Sefa dhe të akuzuarit, me datë 21.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. B. nga i ati L. dhe e ëma A. e lindur G., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme, kamarier, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 20.02.2016 rreth orës 20:30 minuta, në Prizren rrugën me gjatë kontrollit nga ana e zyrtarëve policor të veturës së markës “Audi” me targa të regjistrimit *numri i targës...* dhe gjatë kontrollimit të akuzuarit, tek ai është gjetur substanca bimore me ngjyrë gjelbër e cila sipas karakteristikave morfologjike ka rezultuar se është substanca narkotike e cila përmban kanabis (marihuanë) dhe tetrahidrokanabinol (THC), në peshë të përgjithshme prej 0.53-0.0001 gram, substanca e cila është e rrezikshme dhe e ndaluar me ligj.

Kësodore ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 46, 73 dhe nenit 275 par.2 të KPK i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 € (dyqind euro) e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afat ligjor i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues në pajtim me nenin 69 par.1 të KPK i merret substanca narkotike e llojit marihuanë dhe tetrahidrokanabinol (THC), në peshë të përgjithshme prej 0.53-0.0001 gram, si mjet i kryerjes së veprës penale.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.997-5/2016 të datës 21.09.2016, kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga e prokurorit të shtetit i shpalosi, bëri prezantimin dhe elaborimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike më datë 20.02.2016 rreth orës 20:30 minuta, në Prizren rrugën ..., i akuzuari A. B. pa autorizim posedon narkotik, substanca psikotrope dhe analoge, gjatë një kontrolli nga ana e zyrtarëve të policisë, është gjetur një sasi të barit me ngjyrë të gjelbër e cila sipas karakteristikave morfologjike ka rezultuar se është substanca narkotike e cila përmban kanabis (marihuanë) dhe tetrahidrokanabinol (THC), në peshë të përgjithshme prej 0.53-0.0001 gram, substanca e cila është e rrezikshme dhe e ndaluar me ligj.

I akuzuari në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit dhe pas elaborimit të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit, me ç'rast gjykata sipas detyrës zyrtare pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave materiale në të cilat është mbështetur aktakuza e prokurorit të shtetit nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale. Provat të cilat janë paraqitur në aktakuzë i akuzuari me kohë ka qenë i njoftuar dhe atë në pajtim me nenin 246 e 244 të KPPK, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPK dhe për këtë të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethana rënduese e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, gjendja ekonomike – është i gjendjes së varfër ekonomike, gjer më tani nuk ka qenë i gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi dënimin plotësues marrja e sendit është marrë konform nenit 69 par.1 të Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2052/2016 të datës 21.08.2017

**Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja
Teuta Krusha**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.